



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4062 / Prot. 7

Pogradec, më 11 . 11 2025

VENDIM

Nr. 109 , DATË 10.11.2025

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR EKONOMITË PYJORE QAFË-PANJË DHE GURI I NIKËS”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, nenit 3, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja “k”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 11 pika 2/b të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, i ndryshuar, nenit 14 të Ligjit nr. 111/2024, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullësor”, i ndryshuar, ligjin Nr.5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin sipas listës së Inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në pronësi të ish Komunave/bashkive”, i ndryshuar, VKM Nr.171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullësor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullësor Kombëtar”, bazuar kontratës Nr.3153/6, datë 11.11.2024 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet, Bashkia Pogradec dhe subjektit “XHET” sh.p.k, Librazhd-Albania, me Nipt M08429601A, përfaqësuar nga administratori Xhevdet XHEPI, me objekt: “Hartim Plani menaxhimi ekonomia pyjore “Guri i Nikës” dhe Ekonomia Pyjore “Qafë-Panjë”, si dhe ne



vijim të relacionit i përgatitur nga Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Shërbimit Pyjor), i cili është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, me propozim të Kryetarit,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e mbarështimit të ekonomive pyjore “Guri i Nikës” dhe Ekonomia Pyjore “Qafë-Panjë”, të hartuar nga Subjekti “XHET” Shpk me NIPT **M08429601A**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Shërbimit Pyjor) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planit të mbarështimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet.
3. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Shërbimit Pyjor), për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 2

4.Vota Abstenim 2

5.Zbardhur më date 11.11.2025

